

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6489
E martë, 14 dhjetor 2021
çmimi 0.40 €

Opinioni i Komisionit të Venecias siguron pavarësinë e sistemit prokurorial



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

MË 14 DHJETOR U BËNË TRI VJET KUR KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS KA MIRATUAR LEGJISLACIONIN PËR SHNDËRRIMIN E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS NË USHTRI TË KOSOVËS

TRI VJET NGA FORMIMI I USHTRISË SË KOSOVËS



Tri vjet më parë Kuvendi i Republikës i Kosovës ka miratuar legjislacionin për shndërrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Ushtri të Kosovës, por pa iu ndërruar emri. Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës votimin dhe miratimin e ligjeve për ushtrinë e vlerësojnë si një ditë historike dhe një nga vendimet më të rëndësishme që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se sot kemi arsye të fuqishme të ndihemi krenarë me të gjitha të arriturat e deritashme të FSK-së, duke qenë të vetëdijshëm se ka ende shumë për të bërë

AKTUALE



PSE VERIU I KOSOVËS ËSHTË STREHË E GRUPEVE KRIMINALE?

F. 6

BASHA: PARTIA DEMOKRATIKE KA RRËZUAR KULTIN E INDIVIDIT

F. 2

NJË I VDEKUR DHE TETË RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

F. 3



EKONOMI



PLANI I BE-SË PËR ULJEN E ÇMIMEVE TË ENERJISË

F. 8

RIZVANOLLI: SITUATA ENERJETIKE PRITET TË RËNDOHET GJATË TRI DITËVE TË ARDHSHE

F. 8

SPORT



KOSOVA SHPALL LISTËN PËR NDESHJET MIQËSORE KUNDËR KUVAJTIT

F. 10

Kosova dhe Shqipëria kanë nevojë të jenë shumë më afër njëra-tjetrës

FAQE 7



BE-ja: PROCESI I ZGJERIMIT MBETET POLITIKA KYÇE

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Basha: Partia Demokratike ka rrëzuar kultin e individit

TIRANË, 14 DHJETOR - Kryetari tashmë i kontestuar i Partisë Demokratike të Shqipërisë (PD), Lulzim Basha, ka deklaruar se demokratët do të bashkohen më 18 dhjetor, në Kuvendin Kombëtar, "për ta zgjedhur sërish të ardhmen". "Demokratët do të bashkohen më 18 dhjetor për ta zgjedhur sërish të ardhmen, e me qytetari do të ofrojnë modelin e ndryshimit që shqiptarët

kërkojnë, për t'i dhënë fund tranzicionit", ka shkruar Basha në një postim në "Facebook". Ai ka pohuar se partia që ai drejtoi nga viti 2013, rrëzoi "kultin e individit". "Ora më e errët është ajo pak përpara agimit. Kështu ishte 31 vjet më parë, kur Partia Demokratike e Shqipërisë u themelua për të ndarë të ardhmen nga e shkuara, për ta sjellë lirinë, për ta rrëzuar kultin e individit

dhe për ta ribashkuar Shqipërinë me Perëndimin. Kështu është sot. Prandaj ditët më të mira i kemi përpara", ka thënë Basha. Këto komente të Bashës vijnë në kohën kur ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, njëherësh ish-kryetar i PD-së, synon ta shkarkojë atë nga çdo pozitë e partisë më 18 dhjetor. Në këtë datë do të zhvillohet një kuvend i partisë, i organizuar nga Basha.



Serbia hapi një bllok kapitujsh në negociatat me BE-në

BEOGRAD, 14 DHJETOR - Në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), Serbia hapi në Bruksel, më 14 dhjetor, negociatat për një bllok kapitujsh.

Në konferencën ndërqeveritare është hapur blloku 4, që ka të bëjë me politikën e transportit, energjisë, rrjeteve trans-evropiane, mbrojtjen e ambientit dhe ndryshimet klimatike.

Duke folur në emër të BE-së, sekretari sloven i shtetit, Gasper Dovzhan, e ka cilësuar këtë hap si sukses i Presidencës slovene, i cili do të ndikojë në dinamikën e procesit negociator. Ai ka thënë



se, megjithatë, përparimin Serbia duhet të bëjë më shumë në reformat e sistemit të

drejtësisë, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe në proceset e brendshme

të rasteve të krimeve të luftës.

Nga Serbia është kërkuar që të ketë rol konstruktiv edhe në dialogun me Kosovën dhe se kjo "do ta përcaktojë edhe dinamikën e negociatave të anëtarësimit".

Komisionari i zgjerimit, Oliver Varhelyi, hapjen e katër kapitujve në negociatat me Serbinë e quajti "sinjal të rëndësishëm jo vetëm për Serbinë, por edhe për gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor". "Negociatat e anëtarësimit po përparojnë dhe BE-ja po i përgjigjet përparimit që bëjnë shtetet candidate. Hapja e negociatave për këta kapituj, do

të thotë se tash mund të fillojë puna e rëndësishme në këto fusha. Na pret punë shumë e madhe", ka thënë Varhelyi. Serbia në këtë konferencë është përfaqësuar nga kryeministrja Ana Bernabiq. Ajo ka thënë se vendi i saj pret së shpejti hapjen e kapitujve të tjerë. Ajo paralajmëroi investime të mëdha të Serbisë në fushën e ruajtjes së mjedisit, një prej temave të përfshira në kapitujt që u hapën më 14 dhjetor. Me hapjen e këtyre kapitujve Serbia tash ka të hapur 22 nga 35 kapitujt në procesin e negociatave me Bashkimin Evropian.

Franca nuk do të imponojë masa të reja kundër koronavirusit



PARIS, 14 DHJETOR - Franca nuk planifikon të imponojë masa të reja tash për tash, pavarësisht rrezikut nga varianti i ri i koronavirusit, "Omicron". Kështu ka thënë zëdhënësi i Qeverisë franceze, Gabriel Attal. "Aktualisht janë rreth 130 raste të konfirmuara me variantin "Omicron", ka deklaruar Attal, duke shtuar se qeveria franceze vazhdimisht është duke e përcjell situatën.

Në anën tjetër, Franca pritet të goditet nga vala e gjashtë e koronavirusit muajin e ardhshëm pas paraqitjes së variantit të ri, pohuan ekspertët shëndetësorë spitalorë në Francë, shkruan "Reuters". "Nuk e thamë asnjë fjalë lidhur me valën e gjashtë, e që

është "Omicron", që do të ndodhë më vonë, në janar", ka thënë Martin Hirsch, udhëheqës i grupit spitalor parisien, AP-HP, ndryshe sistemi më i madh spitalor në Evropë. Njëkohësisht, Franca ende po ballafaqohet me valën e pestë dhe variantin "Delta", pohojnë mjekët.

Varianti i ri i koronavirusit, "Omicron", i raportuar fillimisht në Afrikën e Jugut, megjithatë ka nxitur alarm global, me mbyllje të kufijve dhe kufizime të tjera.

Organizata Botërore e Shëndetësisë paralajmëroi se varianti i ri i koronavirusit "Omicron" paraqet rrezik të madh për rritjen e infeksioneve në të gjithë botën.

Gjermania kërkon që BE-ja ta sanksionojë Dodikun

BRUKSEL, 14 DHJETOR - Bashkimi Evropian duhet ta sanksionojë liderin e serbëve të Bosnjës, Milorad Dodik, për përpjekjet e tij për t'u shpëputur nga Bosnjë e Hercegovina, ka deklaruar ministrja e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock.

Baerbock, që mori pozitën e ministres së Jashtme javën e kaluar, u tha gazetarëve në Bruksel, se situata në Bosnjë dhe Hercegovinë është "shqetësuese" dhe se përpjekjet e Dodikut që Republika Serpska të shpëputet nga Bosnja, ishin

"të papranueshme". "Për mua personalisht kjo nënkupton që regjimi ekzistues i sanksioneve duhet të përdoret dhe kundër zotit Dodik", ka thënë ajo pas një takimi të ministrave të Jashtëm të BE-së, ku ajo bëri presion për sanksionimin e Dodikut.



Një i vdekur dhe tetë raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të martën se në Kosovë është regjistruar një i vdekur dhe tetë raste të reja me Covid-19.

Rastet e reja dolën pas testimit të 1 742 mostrave.

MSh-ja ka njoftuar se në 24-orëshin paraprak janë shëruar edhe 16 pacientë.

Ndërkaq, në Kosovë raste

aktive me Covid-19 aktualisht janë 314.

Sa i përket vaksinimit, në 24 orët paraprake janë administruar 2 892 doza të vaksinës kundër koronavirusit.

Që prej fillimit të fushatës së vaksinimit në fund të marsit, deri më 14 dhjetor, sipas MSh-së, me dy doza të vaksinës janë imunizuar 773 633 persona,

ndërkaq me një dozë 874 041 persona.

Në Kosovë të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat mbi 12 vjeç.

Në vend përdoren dy lloje të vaksinave, ajo "AstraZeneca" dhe "Pfizer/BioNTech". Po ashtu, Kosova ka nisur edhe dhënien e dozës së tretë dhe përforsues të vaksinave kundër koronavirusit.



BE-ja: Procesi i zgjerimit mbetet politika kyçe

BRUKSEL, 14 DHJETOR - Ministrat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të martën, më 14 dhjetor, kanë diskutuar për procesin e zgjerimit dhe të Stabilizim Asociimit.

Në takimin e Këshillit të çështjeve të përgjithshme, ministrat përsëritën përkushtimin e tyre ndaj procesit të zgjerimit që, sipas tyre, mbetet politika kyçe e BE-së. Por, gjatë diskutimit nuk është arritur pajtimi i të gjitha shteteve anëtare për miratimin e konkluzave, pasi disa shtete kanë pasur vërejtje. Prandaj, më vonë gjatë së martës, ministrat do t'i kthehen edhe një herë kësaj teme, për të parë nëse do të ketë pajtim për konkluzat.

Sipas burimeve diplomatike, Bullgaria ka vazhduar të kërkojë që në dokumente të BE-së të futen edhe kërkesat e saj për problemet bilaterale që ka me Maqedoninë e Veriut. Greqia dhe Qiproja kanë pasur vërejtje për pjesën e tekstit që flet për Turqinë, ndërkaq Kroacia ka pasur vërejtje për pjesën e tekstit që i kushtohet reformës zgjedhore në Bosnjë e Hercegovinë.

Presidenca slovene e BE-së insiston që deri në fund të këtij viti të hapen negociatat e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, ndonëse një mundësi e tillë duket pak e arritshme.

Nëse shtetet e BE-së nuk arrijnë pajtim për versionin e ri të tekstit, që mund të dalë gjatë ditës,

atëherë konkluzat do të publikohen si "konkluzat të Presidencës slovene të BE-së". Nëse ndodh kështu, atëherë konkluzat do të jenë më shumë një porosi politike sesa një dokument i përbashkët i Këshillit të BE-së.

Ndryshe, në draftin e konkluzave thuhet se procesi i zgjerimit të bllokut evropian "është një investim në paqe, demokraci, prosperitet, siguri dhe stabilitet në Evropë". "Këshilli nënvizon se mbështetja e vlerave themelore të BE-së dhe perspektiva evropiane janë një zgjedhje e vendosur strategjike, thelbësore për të gjithë partnerët që synojnë anëtarësimin në BE", thuhet në draftin e konkluzave.

Nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor kërkohet që ato t'i përshtatin qëndrimet e tyre të politikës së jashtme me qëndrimet e përbashkëta të BE-së. Po ashtu, kërkohet që edhe politikat e tyre për ruajtjen e mjedisit të jenë në përputhje me strategjinë e BE-së. Kjo kërkohet që të bëhet përmes "agjendës së gjelbër për Ballkanin Perëndimor" dhe të jetë pjesë e përbërëse e planit evropian për investime në Ballkanin Perëndimor.

Këshilli, po ashtu, thekson se sundimi i ligjit është element kyç nga i cili do të varet edhe dinamika e përparimit të vendeve të Ballkanit në procesin e integrimi evropiane.



Në pjesën që i kushtohet Kosovës, në dokument thuhet se BE-ja mirëpret konfirmimin e Qeverisë së re të Kosovës për përkushtimin ndaj rrugëtimit evropian dhe reformat e lidhura me këtë i sheh si një zgjidhje strategjike.

Në dokumentin e konkluzave kërkohet që Kosova ta zbatojë legjislacionin në fuqi dhe të dëshmojë rezultate në luftë kundër korrupsionit dhe, po ashtu, të zbatojë reforma në përputhje me standardet evropiane.

Sa i përket dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, nga të dyja vendet kërkohet që të angazhohen me vullnet të mirë në këtë proces, në frymën e kompromisit, për të

arritur marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërisht obliguese. "Kjo marrëveshje duhet t'i adresojë të gjitha çështjet e hapura dhe të kontribuojë në stabilitetin në rajon. Kjo është kyçe në mënyrë që Kosova dhe Serbia të mund të përparojnë në rrugëtimitin e tyre përkatës evropian. Këshilli përsërit pritjet e fuqishme që të gjitha marrëveshjet e arritura në të kaluarën të respektohen dhe zbatohen pa vonesa. Të dyja palët duhet t'i shmangin veprimet që dëmtojnë stabilitetin dhe retorikën, e cila nuk është e favorshme për dialogun", thuhet në draftin e konkluzave. Gjatë së martës disa ministra

kanë kërkuar që BE-ja të bëjë më shumë për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Ministri i Francës për Çështje Evropiane, Clement Beaune, ka shprehur shqetësim për situatën në Bosnjë dhe Hercegovinë. Shqetësim të njëjtë ka shprehur edhe ministri i Jashtëm i Luksemburgut, Jean Asselborn, i cili ka kritikuar aspiratat separatiste të liderëve të serbëve të Bosnjës, Millorad Dodik.

Ndërkaq, sekretarja e shtetit e Kroacisë, Adreja Metelko-Zgombiq, ka thënë se shteti i saj është i përkushtuar për një Bosnjë dhe Hercegovinë unike, të pandarë, në të cilin tri entitetet gëzojnë të drejta të barabarta.

Ministri Krasniqi: Qëllim im kryesor, qeverisja e hapur

PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, para anëtarëve të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Medie dhe Zhvillim Rajonal, ka raportuar për të arriturat e MAPL-së, duke përfshirë punët e përfunduara që nga marrja e mandatit si ministër dhe projektet në të ardhmen. Ministri Krasniqi ka theksuar se që nga marrja e mandatit ka pasur synim dhe qëllim kryesor qeverisjen e hapur,

transparencën dhe digjitalizimin e shërbimeve. Në këtë drejtim ai ka përmendur hartimin e planit kombëtar të veprimit për qeverisje të hapur në kuadër të Partneritetit për Qeverisje - GOP dhe platformën E-Komunat e cila synon rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në nivelin lokal.

Rasti i emërimit të nënkryetarit të komunës së Graçanicës nga radha e komunitetit shqiptar,

bashkëpunimi me komunat e Republikës së Kosovës, bashkëpunimi ndërkufitar ishin temat të cilat u trajtuan në pyetjet e anëtarëve të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Medie dhe Zhvillim Rajonal. Në çështjet e adresuara nga anëtarët e komisionit parlamentar, ministri Krasniqi është përgjigjur duke ofruar materialin e nevojshëm dhe sqarimet të cilat lidhen me këto çështje.





MË 14 DHJETOR U BËNË TRI VJET KUR KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS KA MIRATUAR LEGJISLACIONIN PËR SHNDËRRIMIN E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS NË USHTRI TË KOSOVËS

Tri vjet nga formimi i Ushtrisë së Kosovës

Tri vjet më parë Kuvendi i Republikës i Kosovës ka miratuar legjislacionin për shndërrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Ushtri të Kosovës, por pa iu ndërruar emri. Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës votimin dhe miratimin e ligjeve për ushtrinë e vlerësojnë si një ditë historike dhe një nga vendimet më të rëndësishme që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se sot kemi arsye të fuqishme të ndihemi krenarë me të gjitha të arriturat e deritashme të FSK-së, duke qenë të vetëdijshëm se ka ende shumë për të bërë

Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës votimin dhe miratimin e ligjeve për ushtrinë e cilësuan si “një ditë historike dhe një nga vendimet më të rëndësishme që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008”.

Sot në trevjetorin e miratimit të pakos ligjore e cila legjitimoi mandatin ushtarak të FSK-së, krahas themelimit të Ministrisë së Mbrojtjes, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se sot kemi arsye të fuqishme të

ndihemi krenarë me të gjitha të arriturat e deritashme të FSK-së, duke qenë të vetëdijshëm se ka ende shumë për të bërë. “Gëzuar bashkë me ShBA-në, aleatin tonë të pazëvendësueshëm që njohu dhe mbështeti deri në fund vullnetin tonë për ushtrinë që kemi. Gëzuar bashkë edhe me gjithë aleatët e tjerë! Vazhdojmë rrugëtimin përpara drejt realizimit të vizionit tonë: Ushtrinë tonë plotësisht operacionale, profesionale,

multietnike, moderne dhe plotësisht të ndërveprueshme me forcat e vendeve aleate”, ka thënë ai në deklaratën për medie. Mehaj ka thënë se të hënën Kuvendi i Kosovës ka miratuar Projektligjin për dërgimin e FSK-së jashtë vendit. “Siç theksova edhe dje para deputetëve, ky ligj ka domethënie të madhe për procesin e anëtarësimit në NATO. Krahas angazhimit tonë për realizimin e planit të tranzicionit, pjesëmarrja e trupave tona në operacione jashtë vendit përkrah forcave amerikane dhe aleatëve të tjerë është shumë e rëndësishme. Sikur në stërvitjen ‘Defender-Europe’21, operacionin e këtij viti përkrah forcave amerikane në Kuvajt, si dhe atë në mbështetje të forcave të NATO-s të udhëhequra nga ShBA-ja për evakuimin e refugjatëve afganë, kemi dëshmuar fuqishëm se jemi të gatshëm plotësisht për operacionet e ardhshme shumëkombëshe”, ka deklaruar ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj.

Në trevjetorin e miratimit të

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Tri vjet më parë, më 14 dhjetor 2018, Kuvendi i Kosovës me 106 vota për dhe një abstenim, miratoi tri ligjet që e ndryshojnë mandatin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri të Kosovës, por pa iu ndërruar emri. Ligjet e miratuara ishin Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së

Kosovës. Amendamentet e ligjeve ishin votuar një nga një. Deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës nuk morën pjesë në seancë, pasi ishin kundër formimit të Ushtrisë së Kosovës. Gjeneralmajor Bashkim Jashari është komandanti i ri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së). Emërimi i nipit të Adem Jasharit, komandantit legjendar të UÇK-së, në krye të ushtrisë së Kosovës, ka ardhur pas dorëheqjes të komandantit të deritashëm të FSK-së, Rrahman Rama.



Opinionit i Komisionit të Venecias siguron pavarësinë e sistemit prokurorial

Prishtinë, 14 dhjetor (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka mirëpritur opinionin e Komisionit të Venecias lidhur me draft-amendamentimin e Ligjit për KPK-në. Ky opinion siguron ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë e sistemit prokurorial duke ritheksuar se iniciativat e ndërmarrja nga Ministria e Drejtësisë për ta ndryshuar Ligjin për KPK-në me këto propozime janë në kundërshtim me praktikat dhe standardet ndërkombëtare.

Në opinion, përkatësisht në pikën 49, theksohet se procedura e zgjedhjes së anëtarëve laikë (që nënkupton edhe iniciativën e

zgjedhjes së anëtarit prokuror nga Kuvendi i Kosovës) është shumë e ndërlikuar, e paqartë dhe krijon mundësi për manipulime.

Komisioni i Venecias në pikën 57 të këtij opinionit, ngreh dy shqetësime kryesore: Një "Këshill i reduktuar" që do të përbëhej ekskluzivisht prej anëtarëve laikë (duke përfshirë edhe prokurorin e zgjedhur me shumicë të thjeshtë nga ana e Kuvendit të Kosovës) do të ketë të njëjtin pushtet si Këshilli Prokurorial i Kosovës me përbërje të plotë, dhe më e rëndësishmja se ai do të vendosë për zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri të Shtetit që do të bëhet në fillim të vitit 2022.

Çështja e dytë është se i njëjti "Këshill i reduktuar" me përfaqësues laikë do të sigurojë kontroll të plotë në komisionin zgjedhor që mbikëqyr procesin e zgjedhjes së anëtarëve të rinj të Këshillit nga kolegët e tyre.

Sipas mendimit të Komisionit të Venecias, ndryshimet e propozuara nga Ministria e Drejtësisë janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, dhe këto ndryshime propozojnë largimin e prokurorëve nga qeverisja e sistemit prokurorial në momentin më kritik kur do të zgjidhet kryeprokurori i Shtetit dhe anëtarët prokurorë nga

radhët e tyre.

Ndërsa sa i përket shkëputjes së mandatit të anëtarëve aktualë të KPK-së, Komisioni i Venecias në pikën 54 rithekson se ndërprerja e mandatit të parakohshëm të një anëtari të Këshillit (kur nuk vjen për shkak të dorëheqjes vullnetare, shfuqizimit të tërë institucionit ose për arsye të tjera të ngjashme) duhet të lidhet gjithmonë me një keqbërje të identifikueshme ose dështim në ushtrimin e detyrës së tij ose të saj. Anëtarët e KPK-së nuk duhet të "fajësohen" thjesht sepse shumica parlamentare ose kolegët e tyre nuk pajtohen me vendimet që ata marrin.

Po ashtu, në konkluzionet e opinionit, në pikën 71, shprehimisht thuhet se reforma nuk duhet të çojë në nënshtrimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës ndaj shumicës qeverisëse e që propozimi i Ministrisë së Drejtësisë rritë rrezikun e ndikimit të panevojshëm politik mbi KPK-në.

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka theksuar se mbetet i përkushtuar që të punojë në drejtim të zbatimit të plotë të Strategjisë së Sundimit të Ligjit e cila ruan pavarësinë institucionale dhe synon ta avancojë forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.



pakos ligjore rreth mandatit të ri ushtarak të FSK-së, ka reaguar edhe ish-kryeministri Ramush Haradinaj. Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka shpërndarë një video të organizimit të ceremonisë zyrtare, ku FSK-ja mori mandat të ri ushtarak. "Kosovë, urime trevjetori i ushtrisë!", ka shkruar Haradinaj. Përmes një deklaratë për medie edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se pas shpalljes së pavarësisë ky proces ishte momenti më i rëndësishëm për forcimin e shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës. "Ushtria jonë, që çdo ditë po e dëshmon veten me nivelin e lartë të përgatitjes profesionale dhe përvetësimin të standardeve të NATO-s, nuk do të ishte e tillë pa insistimin dhe vendosmërinë për formimin e saj edhe të dy liderëve tanë historikë Kadri Veselit,

atëherë kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ish-presidentit Hashim Thaçi. Ushtria e Kosovës është krenaria jonë e përhershme", ka thënë Krasniqi.

Qeveria e Kosovës për vitin 2022 i ka ndarë buxhet FSK-së 100 milionë euro.

Kosova në gusht të këtij viti ka marrë donacion nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës 50 mjete ushtarake të blinduara. Në muajin korrik po të këtij viti Qeveria e Kosovës kishte ndarë 4.5 milionë euro shtesë për Ministrinë e Mbrojtjes për blerje të dromëve, kurse në qershor po të vitit 2021 Ushtria e Kosovës është pajisur me disa autobllinda, gjithashtu donacion nga Amerika. E në janar të vitit 2021 ministri i Mbrojtjes në atë kohë, Anton Quni, kishte bërë me dije se Kosova ishte furnizuar me snajperë të teknologjisë së fundit.



Pse veriu i Kosovës është strehë e grupeve kriminale?

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Tetë vjet prejse Kosova dhe Serbia janë pajtuar për integrimin e institucioneve serbe të drejtësisë dhe sigurisë nga veriu i Kosovës në sistemin qendror, në "listën e zezë" të Shteteve të Bashkuara gjenden emra pikërisht nga kjo pjesë e Kosovës.

Të qenët e një personi në "listën e zezë" nënkupton aplikimin e sanksioneve amerikane kundër tij. Sanksionet bllokojnë pronën e individëve, ndërsa shtetasve amerikanë ua ndalojnë bashkëpunimin me ta.

Njerëz nga veriu i Kosovës janë futur në listën e zezë të ShBA-së sepse, siç është thënë, ata kanë marrë pjesë në rrjete korruptive, të lidhura me krimin e organizuar transnacional.

Veriu i Kosovës përbëhet nga katër komuna me shumicë serbe, të lidhura territorialisht: Mitrovica e Veriut, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku. Ato kanë filluar të funksionojnë në sistemin e Kosovës në vitin 2013, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi beson se institucionet e Kosovës nuk e kanë kryer punën e tyre siç duhet, gjë të cilën, siç thotë, e ka konfirmuar edhe lista e zezë e Departamentit amerikan të Thesarit, e publikuar më 8 dhjetor.

Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", Miftaraj thotë se grupi kriminal, i cili është përfshirë në listën e zezë të ShBA-së, është i njohur në mbarë Kosovën. Sipas tij, ai "bën biznes shumë lehtë", sepse "e ka mbrojtjen e politikanëve dhe institucioneve të drejtësisë". "Mesazhi që ShBA-ja ka dëshur t'u dërgojë institucioneve të Kosovës, është se ato nuk po e bëjnë punën e tyre, nuk i kanë hetuar apo ndjekur penalisht [anëtarët e grupit kriminal]", thotë Miftaraj. Ai shton se vendet që nuk janë në gjendje të luftojnë korrupsionin, janë nën kontrollin e grupeve kriminale. ShBA-ja e ka identifikuar biznesmenin Zvonko Vesellinoviç si udhëheqës i grupit kriminal nga veriu i Kosovës, ndërsa ka sanksionuar edhe dhjetëra emra të tjerë të lidhur me të. Në vitin 2011 misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, e ka identifikuar Vesellinoviçin si një prej organizatorëve të trazirave në veri.

Bashkëpunimi i grupeve kriminale dhe politike

Verolub Petroniq, ekspert i sigurisë nga Mitrovica e Veriut, i cili është edhe kryetar i



organizatës "Human Center Mitrovica", thotë për "Radion Evropa e Lirë" se grupet kriminale nga veriu i Kosovës janë forcuar shumë. Prej kohësh, thotë ai, ato i "kanë kaluar kufijtë". Bashkëpunimi i tyre me grupet e interesit politik është gjerësisht i njohur, thotë Petroniq. "Biznesi që lidhet me krimin është rritur aq shumë në aspektin e parave, sa që tani edhe Serbia, edhe Ballkani janë të vegjël për të", thotë Petroniq. Në deklaratën e Departamentit Amerikan të Thesarit, të lëshuar më 8 dhjetor, thuhet se grupi i kimit të organizuar ka bërë komplot me politikanë të ndryshëm për favore të ndërsjella, përfshirë dhënien e ryshfetit zyrtarëve kosovarë të sigurisë, për të lejuar operacione të kontrabandës midis Serbisë dhe Kosovës në fillim të vitit 2019 dhe dhënien e ryshfetit zyrtarëve kufitarë të Kosovës për t'u lejuar kontrabandistëve kalim të sigurt në fund të vitit 2017.

Petroniq beson se grupet kriminale serbe dhe shqiptare bashkëpunojnë dhe shton se institucionet e drejtësisë në Kosovë është dashur të reagojnë dhe ta zbatojnë ligjin në veri të Kosovës.

Një nga mënyrat për ta "dekriminalizuar veriu", thotë Petroniq, është përmes Listës Serbe - partisë udhëheqëse të serbëve të Kosovës, e cila është formuar me mbështetjen e Beogradit dhe të presidentit aktual të Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Petroniq thekson se për diçka të tillë është i nevojshëm vullneti politik.

Duke qenë se nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoiçiq, është në listën e zezë të ShBA-së, partia e tij ka thënë më 9 dhjetor se "akuzat e pabaza kundër serbëve nga veriu janë një fushatë e koordinuar" që, sipas tij, synon "dobësimin e unitetit dhe të mbrojtjes së popullit tonë në këto hapësira".

Radoiçiq është bërë nënkryetar i Listës Serbe në vitin 2018, pak muaj pas vrasjes së politikanit opozitar nga Mitrovica e Veriut, Oliver Ivanoviç.

Millan Radoiçiq dhe Zvonko Vesellinoviç janë përmendur në dokumentet e institucioneve të drejtësisë në Kosovë në lidhje me vrasjen e Ivanoviçit. Në aktakuzë ata përmenden si "udhëheqës të një grupi kriminal", i cili vazhdimisht ka bërë përpjekje ta vendosë Mitrovicën e Veriut nën kontrollin e tij. Megjithatë, akuza kundër tyre nuk është ngritur kurrë, sepse ata nuk kanë qenë në dispozicion të gjyqësorit.

Për Radoiçiqin është lëshuar një urdhër arresti, por ai është tërhequr në mars të këtij viti, pa ndonjë shpjegim.

Vesellinoviç dhe Radoiçiq janë të njohur edhe për organet e drejtësisë në Serbi qysh në vitin 2011, kur kundër tyre është ngritur aktakuzë për përvetësimin e 32 kamionëve nga kompania "Hypo Alpe Adria Leasing".

Aktakuza është ngritur në

Gjykatën Speciale në Beograd, në kohën kur ka filluar dialogu për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë.

Të dy janë liruar nga akuzat në vitin 2016.

Bojana Pavloviç, nga Rrjeti për Hulumtimin e Krimin dhe Korrupsionit në Serbi - KRIK, thotë se Kosova nuk ka arritur ta shtrijë kontrollin në veri dhe se Serbia, për ta mbajtur kontrollin e saj në atë pjesë, ka bashkëpunuar me "njerëz me biografi të dyshimta". Ajo thotë se këta persona kanë ndikim të madh në Listën Serbe, e cila është e afërt me Partinë Përparimtare Serbe të Aleksandër Vuçiqit.

Pavloviç thotë se ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, është takuar me Millan Radoiçiqin dhe se KRIK ka publikuar edhe fotografi, në të cilat Radoiçiq duket në shoqërinë e politikanit kosovar Behgjet Pacolli. "Paratë kryejnë punë, disa gjëra në këtë kuptim bëhen me dymë, jashtë institucioneve", thotë Pavloviç për "Radion Evropa e Lirë". Sipas saj, institucionet e Kosovës nuk kanë vullnet për ta zgjidhur çështjen e krimin.

Veriu i Kosovës si burim i paqëndrueshmërisë

Në listën e zezë të ShBA-së është edhe ish-shëf i operacioneve të Policisë së Kosovës në veri, Zhelko Bojiç, për shkak të lidhjeve të tij me Zvonko Vesellinoviçin. Bojiç ka kohë që

është në arrati, pasi Prokuroria e Kosovës e ka lidhur me vrasjen e Oliver Ivanoviçit.

Besa Ramaj, eksperte e sigurisë, thotë se veriu i Kosovës, në periudhën e pasluftës, ka qenë gjithmonë burim i paqëndrueshmërisë. Ajo beson se e gjithë kjo lidhet me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve. Sipas saj, marrëveshja përfundimtare mes dy palëve është e domosdoshme për stabilitetin e rajonit.

Ramaj i sheh sanksionet e ShBA-së si një hap pozitiv, që do të thotë se nuk do të tolerohet më destabilizimi i situatës. "Qeveria e Serbisë ka ende ndikim të madh atje [në veri] dhe e përdor këtë si avantazh për ta çuar përpara agjendën e saj. Më vjen keq për qytetarët që jetojnë në atë pjesë. Ne kemi nevojë për një fushatë më agresive për rrugën evropiane të Kosovës dhe Serbisë, në mënyrë që dialogu të shkojë kah fundi dhe të arrihet njohja reciproke", thotë Ramaj.

Zyrtarët e Kosovës i kanë mirëpritur sanksionet e ShBA-së kundër grupit të serbëve nga veriu i Kosovës, ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se autoritetet kompetente të vendit të tij do të hetojnë nëse ka "akuza të rënda".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka paralajmëruar më 10 dhjetor mobilizim në luftën kundër grupeve kriminale, "pavarësisht etnisë".

Kurti: Ligji për financimin e partive politike duhet t'i përcaktojë qartë burimet e financimit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Ligji për financimin e partive politike duhet t'i përcaktojë qartë burimet e financimit, shumat e lejueshme dhe duhet të ofrojë transparencë maksimale ka thënë kryeministri Albin Kurti në hapje të diskutimit publik për Projektligjin për Financimin e Partive Politike.

"Zgjedhjet, baza e demokracisë, varen nga një elektorat i mirinformuar, i cili zgjedhjen e bën mbi bazën e fakteve. Të njëjtat nuk mund të varen nga korporatat, grupet lobuese apo interesat speciale të cilat shkruajnë çeqe, përderisa populli paguan faturën", ka thënë ai.

Kryeministri Kurti ka thënë se qeveria vërtet shpreson që në këto parime të kenë konsensus ndërpartiak sepse, sipas tij, është për të mirën e përgjithshme dhe nuk mund të lejojnë që rezultatet e

zgjedhjeve, më pastaj edhe qeverisja, të përcaktohen nga korporatat. "Transparenca e financimit duhet të konsiderohet qenësore", ka thënë kryeministri Kurti, duke theksuar se demokracia dhe transparenca në institucione e shoqëri e pësojnë rëndë kur këto vlera mungojnë nëpër partitë politike, në fushatat zgjedhore apo edhe jashtë tyre. "Për këtë edhe jemi mbledhur sot këtu, ashtu që së bashku t'i japim drejtim të duhur Projektligjit për Financimin e Partive Politike e ta konsiderojmë formën më të mirë për këtë, ashtu që dispozitat e hartuara të tregojnë që konsensusi politik në Republikën e Kosovës ndërtohet mbi vullnetin e përbashkët për transparençë, llogaridhënie dhe luftim të korrupsionit", është shprehur Kurti.

Marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji dhe dështimin e hyrjes në fuqi të të njëjtit për vite me radhë në mungesë të



konsensusit politik, Zyra e Kryeministrit e Republikës së Kosovës organizoi diskutimin me partitë politike dhe

organizatat joqeveritare, ashtu që ky projektligj të miratohet në dritë të një procesi të mirëfilltë demokratik e të reflektojë në

kontributin e përbashkët të të gjitha partive politike, në drejtim të hartimit e pastaj edhe të miratimit të këtij projektligji.

Kosova dhe Shqipëria kanë nevojë të jenë shumë më afër njëra-tjetrës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim kryetarin e grupit parlamentar të Partisë Socialiste në Kuvendin e Shqipërisë, Taulant Balla, i cili shoqërohej nga deputetët Anila Denaj, Arben Pëllumbi, Gerta Duraku, Benet Beci, Alqi Bllako dhe ambasadori Qemal Minxhozi me bashkëpunëtorët e tij. Në këtë takim diskutimi është përqendruar në konkretizimin e bashkëpunimit ndërparlamentar, ekonomik, kulturor, arsimor, si dhe në domosdoshmërinë e thellimit të marrëdhënieve në të gjitha fushat e interesit të përbashkët.

Kryetari Glauk Konjufca ka vënë në pah kontributin e madh të Shqipërisë për Kosovën dhe, pasi ka shprehur mirënjohje të lartë, ka thënë se do të punojnë për shtimin e raporteve mes dy



parlamenteve, si dhe ka kërkuar një strategji të përbashkët kundër përpjekjeve të Serbisë për ta

sfiduar Kosovën në mekanizmat parlamentarë evropianë. "Meqë jemi një komb, kemi nevojë të

jemi shumë më afër njëri-tjetrit për t'i përballuar sfidat që kemi përpara në raport me zhvillimet

në Ballkanin Perëndimor dhe integritet evropianë", ka thënë Konjufca.

Nga ana e tij kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, ka premtuar bashkëpunim konkret në të gjitha nivelet, duke u shprehur se Shqipëria do të pozicionohet gjithëherë në interes të faktorit shqiptar.

Bashkëbiseduesit, po ashtu, kanë vlerësuar se Kuvendi i Kosovës dhe ai i Shqipërisë duhet t'i shërbejnë heqjes së të gjitha barrierave eventuale burokratike, unifikimit të qëndrimeve karshi nismave rajonale dhe bashkërendimit të hapave në rrugëtimet integruese.

Në këtë frymë ata kanë konstatuar se takimet e tilla janë pa dyshim tregues i bashkëpunimit të ngushtë politik dhe janë pajtuar që ai të shtrihet në të gjitha fushat si dhe t'i shërbejë forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Përfundojnë për këtë vit seancat gjyqësore ndaj Salih Mustafës

HAGË, 14 DHJETOR (ER) - Procesi gjyqësor ndaj ish-epropolit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Salih Mustafa, do të vazhdojë nga 18 janari i vitit 2021. Gjykimi për sivjet ka përfunduar me dëgjimin e dëshmitarit të dhjetë të Zyrës së Prokurorit

të Specializuar (ZPS), i cili ka dëshmuar nën masa mbrojtëse të sigurisë dhe pjesa më e madhe e seancës është zhvilluar e mbyllur për publikun.

Dëshmitari i dhjetë i ZPS-së është i fundit për këtë vit, ndërsa në janar të vitit 2022

pritet të dëgjohen edhe tre dëshmitarë të tjerë të kësaj zyre. Pas dëgjimit të tre dëshmitarëve të fundit, ZPS-ja nuk planifikon të paraqesë dëshmitarë apo prova të tjera materiale, ka bërë me dije të martën ndihmësprokurorja Silvia D'Ascoli.



Plani i BE-së për uljen e çmimeve të energjisë



Prishtinë, 14 dhjetor - Bashkimi Evropian pritet që gjatë kësaj jave të propozojë një sistem që do t'i lejojte shtetet që bashkërisht të blinin rezerva strategjike të gazit - një masë e hartuar nga blloku evropian në përgjigje të rritjes së çmimeve të energjisë. Çmimet standarde të gazit me shumicë në Evropë u rritën më shumë se 500 për qind gjatë këtij viti, duke arritur nivele rekord në muajin tetor, pasi furnizimet e pakta me gaz përkuan edhe me kërkesën në rritje të ekonomive që po rimëkëmben nga pandemia e Covid-19.

Pavarësisht se çmimet kanë rënë, ato vazhdojnë të jenë të larta.

Shumica e qeverive evropiane u përgjigjen me masa emergjente, të tilla si subvencione apo lehtësira tatimore, me qëllim që t'i mbrojnë qytetarët e tyre nga faturat e larta të energjisë.

Disa shtete, përfshirë Spanjën dhe Francën, kanë kërkuar që BE-ja t'i lejojë ato që bashkërisht të blejnë gaz dhe të krijojnë rezerva strategjike, me qëllim që t'i rritin furnizimet e tyre.

Komisioni Evropian pritet që gjatë kësaj jave të propozojë një reformë sa i përket rregullave të tregut të gazit në BE. Shefja e BE-

së për politikën të energjisë, Kadri Simson, ka thënë se në këtë reformë do të përfshihet një kornizë që do ta mundësojë prokurimin e përbashkët të rezervave strategjike të gazit. Në një dokument të KE-së, të cilin e ka parë agjencia "Reuters", thuhet se çdo blerje e përbashkët e gazit midis shteteve do të bëhet në mënyrë vullnetare.

Pse janë të rëndësishme rezervat e gazit?

BE-ja ka kapacitet që të ruajë në depo deri në 117 miliardë metra kubikë të gazit natyror ose afërsisht një të pestën e konsumit të saj vjetor, thuhet në të dhënat e Gas Infrastructure Europe.

Depot ku ruhet gazi zakonisht janë minierat e kripës apo fushat e gazit, të cilat nuk kanë më gaz. Magazinimi i gazit është i nevojshëm për t'i balancuar luhatjet e kërkesës ditore dhe sezonale. Po ashtu, gazi u ruajtur nëpër depo mund të përdoret kur ka ndërprerje të furnizimit me gaz, kur ka ndërprerje të mëdha në infrastrukturë dhe veçanërisht kur ka kërkesa të mëdha gjatë motit të ftohtë.

Kapaciteti i ruajtjes së gazit në BE

është i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në objekte të mëdha që gjenden në Francë, Gjermani, Itali dhe Holandë, por ndërlidhja me tubacione nënkupton që shtetet anëtare të bllokut mund ta përdorin gazin që ruhet për vite të tëra në shtetet fqinje.

Gjatë muajve të verës, kur çmimet e shitjes me shumicë rëndomë janë më të ulëta, gazi zakonisht vendoset në depo që të përdoret gjatë dimrit, kur kërkesa dhe çmimet rriten.

Ky vit ishte i jashtëzakonshëm, pasi rezervat e gazit ishin më të ulëta për një sërë arsyesh, përfshirë edhe çmimet jashtëzakonisht të larta, që nënkupton se gazi u shit në vend se të ruhej në depo.

Çfarë janë rezervat strategjike të gazit?

Thënë thjesht, shtetet mund të blejnë bashkërisht gaz dhe t'i ndajnë me njëri-tjetrin rezervat e gazit. Spanja, Franca dhe shtetet e tjera që përkrahin këtë ide, kanë thënë se udhëzimet e përbashkëta për rezervat e gazit mund ta "zbutin rritjen e çmimeve", ndërkohë blerja e gazit në mënyrë të koordinuar mes shteteve mund të rritë fuqinë e

tyre negociuese.

Komisioni Evropian pritet që t'i publikojë hollësitë e planit të tij dhe shumë pyetje kanë nevojë të marrin përgjigje, përfshirë edhe atë se si shtetet do të kenë qasje në rezervat e gazit dhe implikimet që mund të kenë kompanitë që i zotërojnë ato rezerva. Çdo rishikim i rregullave të BE-së kërkon negociim nga vendet e BE-së dhe Parlamenti Evropian, një proces ky që mund të zgjasë me vite - megjithëse, kur bëhet fjalë për masa urgjente, ky proces mund të bëhet edhe më shpejt.

A ndihmon plani i ri për shmangjen e rritjes së çmimeve?

Shtetet e BE-së janë përgjegjëse për politikën e tyre të energjisë, prandaj shtetet individuale kanë burime të ndryshme të energjisë dhe ndërtesa për ruajtjen e gazit. Në këtë periudhë të vitit, BE-ja ka furnizime më të pakta të gazit sesa zakonisht. Deri në fund të nëntorit rezervat e gazit të BE-së ishin të mbushura deri në 68 për qind të kapacitetit, që do të thotë se blloku evropian do të duhet të importojë 5 deri në 10 për qind më shumë gaz gjatë dimrit, është thënë në dokumentin e

Komisionit Evropian, që u ishte dërguar shteteve të BE-së para samitit të 16 nëntorit, dokument të cilin e ka parë "Reuters".

Nivelet e ulëta të rezervave nuk janë shkaku i vetëm i rritjes së çmimeve: Evropa konkurron me Azinë për furnizime me gaz të lëngshëm natyror, gjë që rrit çmimet; furnizimet me gaz rus kanë qenë më të ulëta se zakonisht; çmimet e karbonit kanë qenë në nivele rekord gjatë këtij viti; prodhimi i energjisë përmes erës ka rënë dhe ka pasur ndërprerje të mëdha të infrastrukturës.

Shtetet kanë paraqitur edhe propozime të tjera në përgjigje të rritjes së çmimeve të energjisë.

Spanja dhe Franca janë në mesin e shteteve që po kërkojnë ndryshimin e rregullores në mënyrë që çmimi i energjisë elektrike të ndahet nga çmimet e gazit dhe që çmimet e gazit të lidhen me koston mesatare të prodhimit në çdo shtet të BE-së. Këto shtete thonë se sistemi aktual, sipas të cilit termocentralet e gazit zakonisht e përcaktojnë çmimin e energjisë elektrike, bën që konsumatorët të mos përfitojnë nga çmimet më të lira në shtetet ku energjia prodhohet nga burimet e ripërtërishtme apo në shtetet që përdorin disa burime për prodhimin e energjisë.

Po Britania?

Britania mund të marrë dhe të dërgojë gaz në Evropë përmes tubacioneve. Ky shtet nuk ka depo të gazit, pasi kompania energjetike britanike, Centrica, mbylli depon e saj më 2017, duke thënë se mirëmbajtja e kësaj depoje ishte shumë e kushtueshme.

Kjo bëri që Britania - ku rreth 80 për qind e shtëpive ngrohen përmes gazit - të ketë kapacitet të magazinimit të barabartë me rreth katër deri në pesë ditë të kërkesës me gaz gjatë sezonit të dimrit, nga 15 ditë sa kishte më parë.

Nëse BE-ja krijon një rezervë strategjike, ka pak gjasa që Britania të përfshihet në të, pasi ky shtet u largua nga Bashkimi Evropian.

(REL/Përgatiti: Mimoza Sadiku)

Rizvanolli: Situata energjetike pritet të rëndohet gjatë tri ditëve të ardhshme

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se situata energjetike në Kosovë gjatë tri ditëve të ardhshme pritet të rëndohet, duke shtuar se mjetet e parapara për import të rrymës për tërë vitin janë shpenzuar për vetëm dy muaj. Rizvanolli gjatë

raportimit në Komisionin për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti është shprehur se një bllok i termocentralit "Kosova B" ka dalë jashtë funksionit. "KEK-u zakonisht operon me dy blloqe të termocentralit 'Kosova A' dhe dy blloqe të 'Kosova B', që i bie rreth 800 MW në orë. Është bërë

përpjekje edhe e shtimit në funksion të një blloku tjetër të 'Kosova A', duke rritur kapacitetet për 120 MW. Fatkeqësisht, tentimi për t'i mbajtur të tri blloqet njëkohësisht nuk ka funksionuar", ka deklaruar Rizvanolli.



“America First”: Dilema shekullore e SHBA-së, midis izolacionizmit dhe angazhimit global



Nga: George FRIEDMAN

Duke nisur që nga vitet 1930, në Shtetet e Bashkuara kanë pasur një debat mbi politikën e jashtme të bazuar në sloganin “America First” (E para vjen Amerika), një politikë nacionaliste, e cila u jep përparësi objektivave të SHBA-së mbi ato të tjerat. Kjo është një qasje, e cila në periudha të ndryshme ka qenë thelbësore për demokratët dhe republikanët.

Qëndrimet kanë variuar nga e djathta, që kërkon që SHBA-ja të mos marrë përgjegjësinë për fatin e kombeve të tjera, deri tek e majta që pretendon se vendi është i përcaktuar të jetë “xhandari” i botës. E majta ka mbështetur një strategji, sipas së cilës Shtetet e Bashkuara duhet të mbeten të përfshira në botë përmes aleancave.

Në kampin e djathtë, ka ekzistuar besimi se SHBA duhet të mbetet e përfshirë me botë, në mënyrë që për shembull të mposhtë komunizmin. Ky slogan ka marrë karakterin e një parimi moral dhe të veprimit të matur në të dyja prirjet ideologjike, dhe po ashtu shihet si një detyrim moral.

Çështja e marrëdhënieve të duhura të Shteteve të Bashkuara me pjesën tjetër të botës, ka qenë shumë e rëndësishme që nga themelimi i Amerikës. Thomas Xheferson kërkoi mos-ngatërrimin e Amerikës në aleancat me vendet evropiane, ndërsa Xhorxh Uashingtoni dhe Benjamin Franklin po përpiqeshin të përfshinin

Francën në Revolucionin Amerikan.

Amerika u themelua si një alternativë ndaj Evropës, si një rend i ri. Ai ishte gjithashtu një komb në mesin e shumë të tjerëve, dhe për njëfarë kohe shumë i dobët. Marrëdhënia e Amerikës me botën, ka qenë gjithmonë e paqartë si çështje praktike dhe morale dhe në periudha të ndryshme dhe për të dyja palët.

Koncepti modern i “America First” u shfaq së pari në vitet para Luftës së Dytë Botërore. Në shumë aspekte Shtetet e Bashkuara ishin futur në Luftën e Parë Botërore kundër vullnetit të tyre, dhe pikëpamja e përgjithshme dhe e arsyeshme ishte se nga ajo u fituan shumë pak gjëra.

E majta e pa ndërhyrjen kundër Adolf Hitlerit si një detyrim moral. Ndërsa e djathta thoshte se detyrimi kryesor moral i Shteteve të Bashkuara ishte garantimi i mirëqenies së amerikanëve, dhe se nëse ndërhyrja ishte një domosdoshmëri morale, Stalini do të ishte një objektivi më i përshtatshëm.

Shtetet e Bashkuara supozonin se oqeanet që ndajnë SHBA-në nga Evropa, do ta mbronin atëngas marrëzitë e Evropës. Por në fakt nuk ishte kështu. Kur Hitleri pushtoi Francën dhe nisi një luftë masive kundër Evropës, në horizont u shfaq një rrezik i madh. Britania kishte në atë kohë marinën më të fuqishme në botë.

Nëse Gjermania do të mundte Britaninë, ajo mund të merrte kontrollin e anijeve të saj, dhe do të vendoste nën

kontroll gjithë Atlantikun e Veriut, gjë që do të përbente një kërcënim ekzistencial për Shtetet e Bashkuara. Lëvizja “America First” e pa ndërhyrjen në atë luftë si një akt bamirësie, dhe jo si një imperativ strategjik.

Por ajo qasje e mbivlerësonte sigurinë e Shteteve të Bashkuara në një botë të rrezikshme. Izolacionizmi ishte i rrezikshëm. Pas Luftës së Dytë Botërore, pikëpamja amerikane ishte se kostoja e jetëve amerikane, ishte rezultat i dështimit për të vepruar më shpejt kundër Gjermanisë dhe Japonisë.

Prandaj ajo reagoi ndaj fuqisë sovjetike, duke e zvogëluar forcën e saj të kohës së luftës, por nuk u demobilizua asnjëherë. Shtetet e Bashkuara krijuan aleancën më të ndërlikuar të mundshme, NATO-n, dhe zbatuan një politikë sipas së cilës, siç tha dikur presidenti Xhon Kenedi “ne do të paguajmë çdo çmim, do të mbajmë çdo barrë, do të përballojmë çdo vështirësi, do të mbështesim çdo mik, do të kundërshtojmë çdo armik, për të siguruar mbijetesën dhe suksesin e lirisë”.

Ky ishte sigurisht angazhimi më ekstrem që mund të ndërmerre çdo komb. Ishte vazhdimi logjik i intervencionimit liberal, i cili i hapi derën një sërë luftërash, duke filluar nga Vietnami, dhe të tjerat që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Dhe ai u mbështet në përgjithësi nga krahu i djathtë.

Në Vietnam, lufta nuk shkoi as keq por as mirë. Thjesht u zhvillua. Doktrina Kenedi u sulmua nga e majta, e cila

argumentoi se duke marrë përgjegjësinë për botën, se SHBA-jaishte bërë një “përbindësh imperialist”, që po zhvillonte një luftë të pamëshirshme, cila nuk ishte punë e saj.

Pikëpamja shkonte përtej Vietnami, tek koncepti se ndikimi dhe fuqia amerikane në mbarë botën, po shfrytëzonte dhe shtypte të drejtat e kombeve të tjera. E majta mbështeste tërheqjen e SHBA-së nga angazhimi global, jo në formën e doktrinës “America First”, por si një doktrinë me të cilën ishte imorale që Shtetet e Bashkuara të ishin xhandari i botës.

Intervencionizmi në fjalimin e Kenedit, ishte një reagim kundër “America First” të para Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse u sulmua fort nga e majta, ky parim mbijetoi. Shtetet e Bashkuara kanë kaluar më shumë kohë në luftë që nga viti 2000, sesa në çdo shekull të mëparshëm.

Dhe që nga sulmet e 11 Shtatori, ajo ka zhvilluar luftëra kryesisht të pasuksesshme. “America First” është një doktrinë e arsyeshme e vetëkuptueshme, nëse kjo nënkupton vendosjen në qendër të interesave amerikane. Çdo komb në botë, vendos në radhë të parë interesat e veta.

Aleancat duhet t’i shërbejnë interesit kombëtar, ashtu siç edhe izolimi. Asnjëra nuk është në vetvete një doktrinë strategjike. Ato janë mjete për një qëllim. Qeveria ka detyrimin moral qëta mbrojë kombin. Ndonjëherë kjo kërkon aleatë dhe ndonjëherë luftë.

Por nëse i referohemi vizionit të Kenedit, do të ishte vendosja e një sërë detyrimesh, të cilat mund të rrënojnë një komb, dhe në fakt ato i kanë kushtuar shumë Shteteve të Bashkuara. Dhe nëse ideja që amerikanët duhen ta vënë në plan të parë Amerikën është e vetëkuptueshme, atëherë ajo që nënkupton kjo në praktikë është delikate dhe komplekse. Izolacionistët në të djathtë menduan se Shtetet e Bashkuara ishin të pathyeshme në qëndrimin e tyre. Ata në të majtë i mendonin Shtetet e Bashkuara si një shtypës brutal. Të dyja analizat ishin të thjeshtëzuar, të dëmshme dhe të pavërteta.

Por në themel të çdo strategjie kombëtare, duhet të jetë kuptimi i interesit kombëtar, i cili nuk është asnjëherë i thjeshtë dhe as i vetëkuptueshëm. Dhe ai i sfidon ideologjitë e thjeshtuara. Bota është një vend i rrezikshëm, edhe nëse nuk duam luftë, lufta mund të na “dojë” ne.

Dhe një parim moral që kërkon luftë të vazhdueshme është i padurueshëm. Çështja është se çfarë do të bëjmë tani. Jo atë që kemi bërë më parë, madje as atë që do të bëjmë më vonë. E ardhmja na befason gjithmonë.

Thelbi është të jemi të zhytur në mendime dhe të vendosim gjithmonë Amerikën në plan të parë, gjë që mund të na çojë në shumë pjesë të botës. “America First” nuk është izolacionizëm, ai është angazhimi ynë moral ndaj kombit. / “Geopolitical Future” – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kosova shpall listën për ndeshjet miqësore kundër Kuvajtit



PRISHTINË, 14 DHJETOR - Përzgjedhësi i Përfaqësues së Kosovës në hendboll, Bujar Qerimi, ka shpallur listën për ndeshjet miqësore me Kuvajtin. "Dardanët" të premtën dhe të dielën luajnë miqësore me kombëtaren e respektuar aziatike. Ndeshjet zhvillohen në Podgoricë. Kosova grumbullohet të mërkurën në Prishtinë, ndërsa të enjten është udhëtimi për në Podgoricë. Ndeshjet me Kuvajtin janë me peshë të madhe për ta rritur konkurrencën në Përfaqësuesen e Kosovës si dhe për ta zgjeruar bazën për selektimet e ardhshme. Disa lojtarë të rëndësishëm të kombëtares mungojnë në këto ndeshje për shkak të obligimeve në klubet e tyre. Ndërkohë përzgjedhësi Qerimi ka ftuar lojtarë që kanë shfaqur formë të mirë në stinorin vjeshtor në Superligën e Kosovës në

hendboll. Është ftuar pivoti i Trepçës, Sali Maxhera, dhe beku i Kastriotit, Festim Mustafa. Të dy ishin grumbulluar edhe në të

LISTA E LOJTARËVE

Agon Bajqinovci	(KH Prishtina)
Kastriot Jupa	(KH Besa Famgas)
Drenit Tahirukaj	(HSC Kreuzlingen)
Deniz Terziqi	(KH Besa Famgas)
Arbios Mushkolaj	(KH Besa Famgas)
Festim Mustafa	(KH Kastrioti)
Drilon Tahirukaj	(Deçani)
Lulzim Shabani	(KH Prishtina)
Haris Berisha	(HSC Kreuzlingen)
Florian Rexha	(KH Vëllaznimi)
Mursel Mehmeti	(KH Besa Famgas)
Jon Muqolli	(KH Besa Famgas)
Elvir Muça Kulic	(HK Torslanda Elite)
Sali Maxhera	(KH Trepça)
Egzon Gjuka	(KH Besa Famgas)
Matej Taçi	(RK Varazdin)
Shaban Zogaj	(Aalborg Handbold)

STAFI TEKNIK

Bujar Qerimi	(Selektor)
Fatmir Muhaxheri	(Trajner)
Meriton Mripa	(Fizioterapeut)

kaluarën. Aloja e Prishtinës, Agon Bajqinovci, është ftuar sërish, njëjtë si Florian Rexha i Vëllaznimit. Të dy ishin pjesë e grumbullimit të kaluar, por pa fituar rastin. Në ekip do të jetë edhe Shaban Zogaj, talenti që po zhvillohet hovshëm në Danimarkë. Emra plotësisht të rinj të "dardanët" janë aloja Matej Taçi, që bën karrierë në Kroaci, si dhe portieri Elvir Muça Kuliq, që luan në Suedi. Të dy kanë shprehur interesim të jenë pjesë e Kosovës dhe do të testohen në ndeshjet ndaj Kuvajtit. Të tjerët në listën e Bujar Qerimit janë emra të konfirmuar.

Kosova grumbullim tjetër do ta ketë në fund të dhjetorit. Ka gjasa të luhen dy ndeshje miqësore me Arabinë Saudite, ndërsa në fillim të janarit janë ndeshjet kualifikuese me Greqinë, Belgjikën e Turqinë.

SHKURT

Vdes ikona e peshëngritjes shqiptare, Ferit Berberi

Është ndarë nga jeta ikona e peshëngritjes shqiptare, Ferit Berberi. Lajmin e ka konfirmuar gazetari Defrim Methasani. "Shuhet një tjetër ikonë e sportit dhe peshëngritjes shqiptare, Ferit Berberi, 'Mjeshtër i Madh'. Pak ditë më parë e telefonova dhe e urova, sepse bëri 75 vjeç. Zëri, në fakt, nuk m'u duk kumbues si herët e tjera. Si duket sëmundja e mushkërive e kishte ngrënë pak e nga pak kolosin e shtangës, ish-trajnerin e suksesshëm dhe sekretarin e federatës për shumë vite. Dinamo dhe kombëtarja, të cilat ai i drejtoi, njohën para viteve '90 shembullin e njeriut të punës dhe sakrificës, shoqëruar me rezultate të niveleve ndërkombëtare. Lamtumirë kampioni i heshtur Ferit Berberi dhe u prehsh në paqe!", ka shkruar Defrim Methasani.

Arsenali ia heq Aubameyangut shiritin e kapitenit

Arsenali nuk ka mundur ta falë shkëlqen e përsëritur të rregullave nga kapiteni i skuadrës Pierre-Emerick Aubameyang. Menjëherë ka ardhur edhe vendimi i klubit për sulmuesin, duke i dhënë këtij të fundit një goditje të madhe, teksa ka vendosur t'ia heqë edhe shiritin e kapitenit. Përveç kësaj, sulmuesi i Arsenalit nuk do jetë i grumbulluar as për ndeshjen që skuadra e tij do ta zhvillojë kundër West Hamit. "Aubameyang nuk do të jetë më kapiteni i ekipit, madje nuk do të thirret për ndeshjen ndaj West Hamit. Ne presim që të gjithë lojtarët t'i respektojnë rregullat, veçanërisht kapiteni", thuhet në njoftimin e klubit.

Barça me njoftim rreth pensionimit të Agueros

Skuadra e Barcelonës ka konfirmuar se Sergio Aguero do ta sqarojë të ardhmen e vet në futboll sot (e mërkurë) në një konferencë për media në "Camp Nou", pas telasheve me zemër. Mediet spanjolle pretendojnë se Aguero do ta njoftojë pensionimin nga futbollit në konferencë, pasi nuk është më në gjendje të luajë futboll profesional. "Këtë të mërkurë (në orën 12:00) Sergio Aguero do të paraqitet (në një konferencë për media) në 'Camp Nou' për ta sqaruar të ardhmen e vet. Në konferencë do të marrë pjesë edhe presidenti i Barcelonës, Joan Laporta", thuhet në njoftimin e Barcelonës. Sulmuesi argjentinas përjetoi vështirësi në frymëmarrje dhe shtrëngim në gjoks në një ndeshje të Barçës kundër Alavesit më 30 tetor.

Ramosi: Nuk e doja Realin, jap jetën për PSG-në

Jo shumë muaj pas largimit nga Reali i Madridit, ish-kapiteni i "Merengues", Sergio Ramos, do të kthehet të luajë kundër Madridit. Shorti i Ligës së Kampionëve e ka vënë ekipin e tij të ri, Paris SG-në kundër ish-ekipit të tij, Realit. "Ky ishte shorti, një kapriçio e fatit. Do të kisha dashur të përballesha me çdo ekip tjetër përveç Realit. Të gjithë e kanë të qartë dashurinë time për Madridin, por tani jam një lojtar i Paris SG-së dhe më duhet t'i mbroj ngjyrat e klubit tim. Do ta jap edhe jetën për klubin që më besoi mua", ka thënë Ramosi.

Messi: Qëllimi ynë është ta fitojmë Ligën e Kampionëve

PARIS, 14 DHJETOR - Ylli argjentinas i PSG-së, Lionel Messi, ka thënë se synimi i tij dhe i skuadrës franceze është ta fitojnë Ligën e Kampionëve. Klubi nga kryeqyteti i Francës në 1/8 e

finale do të përballet me skuadrën e Real Madridit. "Qëllimi i këtij viti për PSG-në është të përpiqemi të arrijmë gjithçka për ta fituar Ligën e Kampionëve. Po punojmë fort dhe të bashkuar të gjithë

për këtë qëllim. Mendoj se ky është synimi për të gjithë ne, në një kompeticion special ku të gjitha skuadrat e mëdha duan të fitojnë dhe ne do të përpiqemi ta arrijmë këtë gjë të parët", ka thënë Messi.



Lewandowski: Mund të ndodhë që një ditë të kaloj në Serinë A

ROMË, 14 DHJETOR - Robert Lewandowski po fiton çdo çmim të mundshëm, përveç atij që kishte më shumë rëndësi, "Topit të Artë". Së fundmi sulmuesi i Bayern Munchenit është

vlerësuar me çmim "Golden Boy", lojtari më i mirë i vitit, një titull që akordohet nga "Tuttosport". Në një intervistë të dhënë, Lewandowski nuk e mohon që një ditë mund të luajë

në Serinë A. "Nuk mund të them asgjë, pasi është diçka që nuk e di, por di që Italia më josh shumë. Mund të ndodhë, pasi në Itali do të kisha mundësi të përballës me lojtarë të

mëdhenj dhe me skuadra të madha. Më kujtohet shumë mirë Roberto Baggio. Isha gjashtë vjeç kur fillova t'i shihja ndeshjet e tij, talentin e tij të madh dhe stilin e tij", ka thënë Lewandowski.



Dy sfida interesante në mesjavë

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Në mesjavë zhvillohet java e 14-t në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll, apo xhiroja e fundit për stinorin vjeshtor. Drita që nuk ka shënuar asnjë fitore në stinorin vjeshtor, duke regjistruar 13 humbje, do të përballlet me Bashkimin, sfidë që zhvillohet në Prizren. Ndërkohë, basketbollistët e Bashkimit kanë regjistruar shtatë fitore dhe gjashtë humbje. Duel shumë interesant shihet ndërmjet



Prizrenit 16 dhe Sigal Prishtinës që, po ashtu, zhvillohet të mërkurën në Prizren. Skuadra prizrenase ka tetë fitore dhe katër humbje, ndërsa ajo prishtinase shtatë fitore dhe gjashtë humbje. Në takimin e parë ndërmjet tyre në këtë edicion, që u zhvillua në kryeqytet, fituan prizrenasit 100:108. Të enjten Trepça do të

sfidohet nga Rahoveci. Mitrovicasit kanë treguar formë të lartë në këtë edicion me nëntë fitore dhe katër humbje, kurse "vreshtarët" kanë filluar këndelljen pas një nisje jo të mirë dhe kanë tri fitore e nëntë humbje. Për ndeshjen Golden Eagle Ylli - Peja do të regjistrohet rezultati nga Liga Unike.

SUPERLIGA - Java 14

Të mërkurë takohen:
17:00 Drita - Bashkimi
20:00 Prizreni 16 - Sigal Prishtina

Të enjten takohen:
19:00 Trepça - Rahoveci
Golden Eagle Ylli - Peja (Rezultati nga Liga Unike)

Ceremonia hapëse e Lojërave Olimpikë Paris 2024 do të mbahet në lumin Sena



PARIS, 14 DHJETOR - Organizatorët e Lojërave Olimpikë Paris 2024 kanë bërë me dije se Lumi Sena (Seine) do të shërbejë si vendi i ceremonisë hapëse të Lojërave Olimpikë, duke e bërë kështu ceremoninë më të veçantë në historinë e Olimpizmit. Ekipet olimpikë do të udhëtojnë me anije për gjashtë kilometra gjatë spektaklit që do të

mbahet më 26 korrik të vitit 2024. Në një konferencë për shtyp, presidenti i Paris 2024, Tony Estanguet, theksoi se Bordi i Parisit 2024 dhe Komiteti Olimpik Ndërkombëtar kanë miratuar lokacionin. Sipas organizatorëve, parashihet që 10 herë më shumë tifozë do të kenë mundësinë ta shohin ngjarjen spektakolare në

ambient të hapur, në krahasim me stadiumet olimpikë ku janë mbajtur zakonisht ceremonitë e tilla. Po ashtu, pritet që mijëra tifozë do të mund të marrin pjesë në ceremoninë e hapjes falas, por që do të funksionojë edhe zona me bileta. Lojërat Olimpikë Paris 2024 mbahen prej 26 korrik-11 gusht të vitit 2024.

SHKURT

Xavi: Garojmë për ta fituar Ligën e Evropës

Barcelona është eliminuar në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve, kurse në Ligën e Evropës do të përballlet me skuadrën e Napolit. Trajneri Xavi Hernandez ka thënë se kundërshtari i Barcelonës është mjaft i fortë, por se synim është të garohet për ta fituar Ligën e Evropës. "Napoli është i vështirë. Kemi pasur një short të pafavorshëm. Është një nga rivalët më të vështirë, është në nivelin e Ligës së Kampionëve. Është pothuajse një tjetër nderim për Maradonën i cili luajti si në Barcelonë ashtu edhe në Napoli", ka thënë Xavi. "Ne po punojmë shumë për ta rikthyer Barcelonën në pozicionin më të mirë në futbollin evropian, që është të garojë në Ligën e Kampionëve. Ne jemi Barça. Duhet të kthehemi sa më shpejt. Ne duhet të garojmë për ta fituar Ligën e Evropës", ka deklaruar Xavi.

Raducanu infektohet me Covid-19

Tenistja 19-vjeçare britanike Emma Raducanu, fituese këtë vit e grand slam të US Open, ka rezultuar pozitive me Covid-19. Për pasojë, ajo nuk do të luajë në turneun e Abu Dhabit, që nis javën e ardhshme. Raducanu, që u kthye në një fenomen botëror për triumfin e saj në grand slamin amerikan, shpresonte të luante në Abu Dhabi për t'u përgatitur për Australian Open. Por sot ka ardhur konfirmimi i tërheqjes së saj për shkak të infektimit me koronavirus. Paraqitjet e saj në dy muajt e fundit kanë qenë zhgënjyese, pas US Open, ndaj ajo synonte një start të mirë të vitit të ri. "Më vjen keq që tërhiqem, pasi dëshiroja shumë të luaja në këtë turne", ka thënë Raducanu, që ka hyrë në karantinë.

Kloppi: Do të jetë sfidë e vështirë ndaj Interit

Për Interin shorti ishte shumë i vështirë, pasi i vendosi një nga rivalët më të vështirë të mundshëm, Liverpoolin. Një ndeshje e denjë për një duel të fazës së 1/8-ve, teksa Jurgen Klopp është i kënaqur që do të rikthehet shumë shpejt në "San Siro" në harkun e pak javëve, pasi sfidoi për herë të parë Milanin. "Prita 54 vjet për të luajtur për herë të parë në 'San Siro', tani më ndodh dy herë brenda tre muajve. Mirë, mirë! Me siguri që do të jetë një ndeshje e vështirë. Interi është kampioni në fuqi dhe një skuadër e mirë për momentin. Të shohim se në ç'moment do të arrijmë në muajin shkurt. Alexis Sanchez dhe Dzeko kanë bërë shumë mirë deri më tani, por është edhe Lautaro, një nga sulmuesit më të spikatur. Simeone Inzaghi është në vitin e parë në krye të kampionëve në fuqi, por ne jemi Liverpooli dhe jemi mësuar me ndeshje të tilla. Nuk është e thjeshtë, por gjithçka është e mundur", ka deklaruar Klopp.

Pesë skuadra në garë për Der Jongun

Frenkie de Jong mund të largohet nga skuadra e Barcelonës, pasi shihet si një lojtar që mund të shitet për të ndihmuar në zgjidhjen e krizës financiare të klubit dhe babai i tij thotë se ka shumë interesim për të. Pesë skuadrat evropiane janë në garë për mesfushorin holandez. John de Jong këmbënguli për Algemeen Dagblad se një lëvizje në Manchester United ose Bayern Munchen mund të mos i pëlqejë ish-yllit të Ajaxit. "Atje shpesh është mot i keq. Sigurisht që ka të bëjë me futbollin, por ka rëndësi. Sigurisht, e di që Barcelona ka nevojë për para dhe një ofertë e shkëlqyer për Frenkie mund të ndihmojë, por nuk e shoh të ndodhë së shpejti. Edhe pse pesë klubet më të mira evropiane kanë thirrur të gjitha", ka deklaruar ai.

Verstappen: Xhiroja e fundit ishte një makth, më zuri ngërçi në këmbë kur i jepja makinës

Max Verstappen, i saposhpallur kampion bote në Formula 1, pas garës dramatike në Abu Dhabi, ka rrëfyer se në xhiron e fundit ka qenë shumë i tensionuar në

njëvendëshen e tij Red Bull. Në atë xhiro ai arriti ta parakalojë rivalin e tij për titull, Lewis Hamilton. Edhe pse për fansat mund të jetë dukur një parakalim i lehtë, me

Verstappenin që kishte gomat e buta, për 24-vjeçarin ajo xhiro ka qenë një makth i vërtetë. "Në atë garë besova deri në fund te fitorja, se ndonjë episod do të më ndihmonte

dhe ashtu ndodhi. E dija që në atë xhiro të fundit kisha vetëm një shans dhe ia dola mbanë. Në atë xhiro kam qenë i ngurtë në makinë, pasi më kishte kapur ngërçi në këmbë.

Shtypja gazin dhe shtrëngoja fort dhëmbët nga dhimbja. I thosha vetes vazhdo, mos u tërhiq, pasi dhimbja ishte vërtet e padurueshme", ka thënë Verstappen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Nermin Bajramaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasës -X-, -XI-, -XII-, diplomën si dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

► Filiz Ferizi shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së -XI- dhe -XII-, dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

► Mirlinda Doli nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

► Kujtim Cika shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Ajshe Ibraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V SHFMU "Mati Logoreci" Prizren

► Rrustem Ibraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHFMU "Mati Logoreci" Prizren

► Hikmet Gashi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Edisa Bituqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Dy Dëshmorët" Piranë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal in më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

